

**VENDIM**  
**Nr. 88, datë 31.1.2020**

**PËR NJË SHITESË FONDI, NGA FONDI PËR RINDËRTIMIN, NË BUXHETIN E  
MIRATUAR PËR MINISTRINË E TURIZMIT DHE MJEDISIT PËR VITIN 2020,  
PËR AKOMODIMIN E PËRKOHSHËM TË TË DËMTUARVE NË QARQET  
DURRËS, TIRANË DHE LEZHË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 27, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936/2016, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në programin buxhetor “Zhvillimi i turizmit” 04760, për institucionin Agjencia Kombëtare e Bregdetit, i shtohet fondi prej 200 000 000 (dyqind milionë) lekësh për përballimin e shpenzimeve të akomodimit të përkohshëm të të dëmtuarve, për shkak të fatkeqësisë natyrore, në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë.

2. Efekti financiar, prej 200 000 000 (dyqind milionë) lekësh, të përballohet nga zëri “Fondi për rindërtimin”, i miratuar në buxhetin e vitit 2020.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Bregdetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**